

## NJOFTIM PUNE

**Profili i kompanisë: Balkan Finance Investment Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

**Pozicioni:** Operator i Kujdesit Ndaj Klientit

**Departamenti:** Operacional

**Vendodhja:** TEG

**Përmbledhja e Pozicionit:** Pret dhe adreson kërkesat/ankesat e klientëve tek personat e duhur. Shërben si urë lidhëse mes kompanise dhe klientëve dhe jep kontributin e tij/saj në përmirësimin e vazhdueshëm të kujdesit ndaj klientit;

### **Detyra dhe Përgjegjësi:**

- Pret telefonatat e klientëve dhe mban shënim kërkesat/ankesat;
- Adreson kërkesat e klientëve tek personat e duhur dhe i ndjek ato deri në zgjidhjen e tyre;
- Mban të informuar klientët në lidhje me kërkesat e tyre;
- Jep zgjidhje klientëve për çështje të ndryshme nëpërmjet telefonit;
- Zhvillon anketime të ndryshme nëpërmjet telefonit;
- Dokumenton kërkesat sipas procedurave;
- Përfshihet dhe në detyra të tjera administrative sipas nevojës.

### **Kërkesat:**

**Edukimi:** Preferohet të zotërojë diplomë universitare.

**Eksperiencat e punës:** Minimumi 1 vit eksperience pune në kujdesin ndaj klientit;

### **Kualifikime të tjera:**

- Të ketë njohuri të mira të produkteve;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze;

- Njohuri shumë të mira kompjuterike;

**Kompetenca personale:**

- Të zotërojë aftësi të mira komunikuese;
- Dëshirë për bashkëpunim dhe ndërveprim;
- I përgjegjshëm dhe i aftë të përballojë fluks të lartë pune;

**Kushtet e punës:** Ofrohet pagë konkurruese.

**Mënyra e aplikimit\*:** Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit [hr@spar.al](mailto:hr@spar.al) duke përcaktuar në subjekt pozicionin, online nëpërmjet faqes së Web-it Spar.al, ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

**Afati i dorëzimit:** 29/01/2017

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*